



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS
REKTORI
www.uamd.edu.al

Nr. 298/11 Prot.

Durrës, më 13/02 / 2015

URDHËR

Nr. 13/1 Datë 13.02 2015

"Për ndryshim në emërim"

Në mbështetje të ligjit nr. 9741, datë 21.05.2007 "Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 685, datë 25.08.2010 "Për riorganizimin e Universitetit "Aleksandër Moisiu", Durrës, të Shkresës së Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës nr.2077 Prot., datë 15.04.2013 "Dërgohet numri i përgjithshëm i personelit i miratuar për vitin 2013", të Vendimit të Këshillit të Administrimit nr. 19, datë 22.10.2013 "Për miratimin e strukturës organizative dhe analitike të personelit buxhetor të Universitetit "Aleksandër Moisiu", Durrës", si dhe të urdhërit të Rektorit nr. 115, datë 13.11.2013 "Për miratimin e strukturës së përgjithshme dhe organikës analitike të personelit buxhetor të Universitetit "Aleksandër Moisiu", Durrës";

URDHËROJ:

1. **Znj. Anila Rapi**, i ndryshon emërimi nga Specialiste Finance në **Përgjegjëse e Sektorit të Financës dhe Buxhetit** pranë Drejtorisë së Menaxhimit Financiar në Universitetin "Aleksandër Moisiu", Durrës.
2. Efektet financiare të fillojnë nga data 11.02.2015.
3. Paga të realizohet në mbështetje të V.K.M. nr. 545 datë 11.08.2011 "Për miratimin e strukturës dhe niveleve të pagave të punonjësve civilë, zëvendësministrit dhe nënpunësve të kabineteve, në Kryeministri, Aparatet e Ministrave të linjës, Administratën e Presidenti, Kuvendit, Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve, Prokurorinë e Përgjithshme, disa institucione të pavarura, institucionet në varësi të Këshillit të Ministrave/Kryeministrit, institucionet në varësi të Ministrave të linjës dhe administratën e Prefektit", si dhe në V.K.M. nr.551, datë 11.08.2011 "Disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.717, datë 23.06.2009 të Këshillit të Ministrave, "Për pagat e punonjësve mbështetës të institucioneve buxhetore dhe nënpunësve të disa institucioneve buxhetore", të ndryshuar.
Paga të realizohet sipas lidhjes nr.7.

4. Për zbatimin e këtij urdhëri ngarkohen:

- Kancelari i Universitetit "Aleksandër Moisiu".
- Dega e Burimeve Njerëzore.
- Drejtoria e Menaxhimit Financiar.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

R E K T O R I

Prof. Dr. Mit'hat MEMA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës
REKTORI

Nr. 126 prot.

Durrës, më 27.06 /2018

URDHËR

Nr. 133, datë 27.06 2018.

PËR

"Ndryshimin e kategorisë së pagës për emërtesën Përgjegjës Sektori"

Në mbështetje të ligjit nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", të ligjit nr.136/2015 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë" si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 187, datë 08.03.2017 "Për miratimin e strukturës dhe niveleve të pagave të punonjësve civilë, zëvendësministrit dhe nënpunësve të kabineteve, në Kryeministri, Aparatet e Ministrive të linjës, Administratën e Presidenti, Kuvendit, Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve, Prokurorinë e Përgjithshme, disa institucione të pavarura, institucionet në varësi të Këshillit të Ministrave, Kryeministrit, institucionet në varësi të Ministrave të linjës dhe administratën e Prefektit".:

URDHËROJ

1. Kategoria e pagës për emërtesën "Përgjegjës Sektori" në Drejtori, të ndryshojë nga kategoria III-b në kategorinë III- a/1.
2. Efektet financiare të fillojnë nga data 08.03.2017.
3. Pagesa të realizohet në mbështetje të V.K.M. nr. 187 datë 08.03.2017 "Për miratimin e strukturës dhe niveleve të pagave të punonjësve civilë, zëvendësministrit dhe nënpunësve të kabineteve, në Kryeministri, Aparatet e Ministrive të linjës, Administratën e Presidenti, Kuvendit, Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve, Prokurorinë e Përgjithshme, disa institucione të pavarura, institucionet në varësi të Këshillit të Ministrave, Kryeministrit, institucionet në varësi të Ministrave të linjës dhe administratën e Prefektit". Lidhja nr.7. Kategoria III-a/1.
4. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri:
 - Administratori i Universitetit "A.Moisiu", Durrës.
 - Sektori i Burimeve Njerëzore.
 - Drejtoria e Administrimit Financiar.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

REKTOR

Prof.Dr.Ksëntela SOTIROFSKI

Konceptoi: Valentina Repçe
P/S/Juridike: Anjeza Meçaj
P/S/Prot.Arshiv: Romina Rexha
Nr i kopjeve: 4 (katër)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 59 prot

Durrës, më 19.07.2018

VENDIM

Nr. 59, datë 19.07.2018

"Miratimin e niveleve të pagave të nëpunësve të administratës dhe punonjësve mbështetës të Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës"

Në zbatim të ligjit nr. 80/2015, datë 22.07.2015 "Për Arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në Insitucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë, ligjit nr. 109/2017 "Për buxhetin e shtetit, për vitin 2018", Vendimin nr. 187 datë 08.03. 2017 "Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve, në kryeministri, aparatet e ministrive të linjës, administratën e presidentit, kuvendit, komisionit qendror të zgjedhjeve, gjykatën e lartë, prokurorinë e përgjithshme, disa institucione të pavarura, institucionet në varësi të kryeministrit, institucionet në varësi të ministrave të linjës dhe administratën e prefektit", pika 1/3/b, Vendimin nr. 202, datë 15.3.2017 "Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 717, datë 23.6.2009, të keshillit të ministrave, "Për pagat e punonjësve mbështetës të institucioneve buxhetore dhe të nëpunësve të disa institucioneve buxhetore", të ndryshuar", Bordi i Administrimit i Universitetit "Aleksandër Moisiu", Durrës, në mbledhjen e datës 24.07.2018,

VENDOSI:

1. Miratimin e niveleve të pagave të nëpunësve të administratës dhe punonjësve mbështetës të Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës, sipas tabelës bashkelidhur.

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen:

Administratori
Drejtorja e Burimeve Njerezore dhe Sherbimeve Juridike
Drejtorja e Administrimit Financiar

3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR I BORDIT TË ADMINISTRIMIT

ALQI KUSHI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS
BORDI I ADMINISTRIMIT
www.uamd.edu.al

Kategoria e pages per cdo anetar te personelit administrativ te UAMD-së

POZICIONI	KATEGORIA E PAGES
Sektori i Koordinimit në Rektorat	
Përgjegjës Sektori	Kategoria III-b
Specialist	Kategoria IV-a
Sekretare Zv. Rektoreve	Klasa VIII
Redaktor Gjuhësor	Kategoria IV-b
Administrator	Kategoria II-b
Sekretare administratori	Klasa VIII
Drejtoria Administrimit Financiar	
Drejtor	Kategoria III-a
Sektori i Buxhetit	
Përgjegjës Sektori	Kategoria III-b
Specialist	Kategoria IV-a
Magaznier	Klasa VI
Sektori i pagesave të studentëve	
Përgjegjës Sektori	Kategoria III-b
Specialist	Kategoria IV-a
Drejtoria e Investimeve dhe Prokurimeve Publike	
Drejtor	Kategoria III-a
Sektori i Prokurimeve	
Përgjegjës Sektori	Kategoria III-b
Specialist	Kategoria IV-a
Sektori i investimeve	
Përgjegjës Sektori	Kategoria III-b
Specialist	Kategoria IV-a
Drejtoria e Shërbimeve të Brendshme	
Drejtor	Kategoria III-a
Sektori i Shërbimeve Mbështetëse	
Përgjegjës Sektori	Kategoria III-b
Specialist	Kategoria IV-a
Shofer	Klasa VI
Punonjës Shërbimi	Klasa VI
<i>Teknik i mesem i specialiteteve te ndryshme</i>	Klasa IV
<i>Punetore mirembajtes</i>	Klasa I
<i>Punonjes pastrimi</i>	
Sektori i organizimit të aktiviteteve	
Përgjegjës Sektori	Kategoria III-b
Specialist	Kategoria IV-a
Drejtoria e Auditimit të Brendshëm	
Drejtor	Kategoria III-a/1

<u>Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Juridike</u>	
Drejtor	Kategoria III-a
Sektori i Burimeve Njerëzore	
Përgjegjës Sektori	Kategoria III-b
Specialist	Kategoria IV-a
Sektori i Shërbimeve Juridike	
Përgjegjës Sektori	Kategoria III-b
Specialist	Kategoria IV-a
Sektori Protokoll - Arshivë	
Përgjegjës Sektori	Kategoria III-b
Specialist protokoll - arshive	Kategoria IV-a
<u>Drejtoria e Projekteve dhe Marrëdhënieve me Jashtë</u>	
Drejtor	Kategoria III-a
Sektori i Planifikimit dhe Monitorimit të Projekteve	
Përgjegjës Sektori	Kategoria III-b
Specialist	Kategoria IV-a
Sektori i Marrëdhënieve me Jashtë	
Përgjegjës Sektori	Kategoria III-b
Specialist	Kategoria IV-a
<u>Drejtoria e Administrimit dhe Shërbimeve Akademike</u>	
Drejtor	Kategoria III-a
Sektori i Publikimit, Statistikave dhe Komunikimit	
Përgjegjës Sektori	Kategoria III-b
Specialist	Kategoria IV-a
Sektori i Teknologjisë së Informacionit	
Përgjegjës Sektori	Kategoria III-b
Specialist	Kategoria IV-a
Sektori i Bibliotekës	
Përgjegjës Sektori	Kategoria III-b
Specialist	Kategoria IV-a
<u>Drejtoria e Kurrikulës dhe Standarteve të Cilësisë</u>	
Drejtor	Kategoria III-a
Sektori i Kurrikulës dhe Sigurimit të Cilësisë	
Përgjegjës Sektori	Kategoria III-b
Specialist	Kategoria IV-a
Sektori i çështjeve mësimore	
Përgjegjës Sektori	Kategoria III-b
Specialist	Kategoria IV-a
<u>Qendra për Kërkim dhe Ekselencë</u>	
Drejtor	Kategoria III-a
Specialist	Kategoria IV-a
<u>Qendra e Trashëgimisë Kulturore Mesjetare</u>	
Drejtor	Kategoria III-a
<u>Personel ndihmes mesimor me karakter administrativ</u>	
Sekretare dekani	Klasa VIII
Kryesekretare	Kategoria IV-a
Sekretare mësimore	Kategoria IV-b
Laborant me arsim të lartë në universitete	Kategoria IV-b
<u>Fakulteti i Studimeve të Integruara me Praktikën</u>	



Handwritten signature/initials.


Handwritten signature/initials.

Handwritten signature/initials.

Handwritten signature/initials.

Sekretare Dekani
Administrator
Koordinator i Prog. Studimit
Specialist Burime Njerezore
Specialist Finance
Kryesekretare
Sekretare Mësimore

Klasa VIII
Kategoria III-a/1
Kategoria IV-a
Kategoria IV-a
Kategoria IV-a
Kategoria IV-a
Kategoria IV-b



Kryetari i Bordit të Administrimit
Alqi KUSHI





REPUBLIKA E SHQIPËRISE
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës
DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE DHE JURIDIKE
SEKTORI I SHËRBIMEVE JURIDIKE

Nr. 1623 prot.

Durrës më 21 / 11 / 2022

Lënda: Propozim për trajtimin me pagë të emërtesës "Përgjegjës Sektori në Drejtori" sipas kategorisë 3-a/1 të VKM-së nr. 187 datë 08.03.2017 të ndryshuar

BORDIT TË ADMINISTRIMIT

KËTU

Të nderuar,

Bazuar në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 187, datë 08.03.2017 "Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nënpunësve civilë, të ndryshuar, vendimin e Bordit të Administrimit nr. 30, datë 31.05.2018 "Për miratimin e strukturës së përgjithshme të Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës dhe në urdhërin nr. 133, datë 27.06.2018 "Për ndryshimin e kategorisë së pagës për emërtesën, Përgjegjës Sektori nga kategoria III-b, në kategorinë III-a/1", në mbështetje të nenit 19 pika "p" të Statutit të UAMD-së ju paraqesim propozimin për trajtimin me pagë të emërtesës "Përgjegjës Sektori në Drejtori sipas kategorisë 3-a/1 të VKM-së nr. 187, datë 08.03.2017" të ndryshuar.

Ju lutem gjeni bashkëngjitur relacionin e Drejtores së Drejtorisë së Burimeve Njerëzore dhe Juridike "Kërkesë për trajtimin me pagë të emërtesës "Përgjegjës Sektori në Drejtori" sipas kategorisë 3-a/1 të VKM-së nr. 187 datë 08.03.2017 të ndryshuar".





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës
DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE DHE JURIDIKE
SEKTORI I SHËRBIMEVE JURIDIKE

Nr. 1623 prot.

Durrës më 2/11/2022

Lënda: **Kërkohet trajtimi me pagë i emërtesës "Përgjegjës Sektori në Drejtori" sipas kategorisë III-a/1 të VKM-së nr. 187 datë 08.03.2017 të ndryshuar**

BORDIT TË ADMINISTRIMIT

Të nderuar,

Në bazë të vendimit të Bordit të Administrimit nr. 30, datë 31.05.2018" Për miratimin e strukturës së përgjithshme të Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës sektori i Burimeve Njerëzore ka hartuar urdhrat e ndryshimeve në emërim të punonjësve aktualë në përputhje me strukturën e re të miratuar nga Bordi i Administrimit.

Në bazë të urdhrat të Rektorit nr. 133 datë 27.06.2018 me nr. 986 prot. (bashkëngjitur) është bërë ndryshimi në kategorinë e pagave të pozicioneve të punës së nënpunësve për emërtesën përgjegjës Sektori në Drejtori e cila të paguhet sipas lidhjes nr. 7 të VKM nr. 187, datë 08.03.2017 kategoria III-a/1.

Ky urdhër është plotësisht i ligjshëm pasi bazohet në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 187, datë 08.03.2017 "Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nënpunësve civilë,, institucionet në varësi të ministrave të linjës dhe administratës së prefektit" pika 1/3/b e këtij vendimi. Sipas VKM –së së mësipërme përgjegjësi i sektorit në nivel drejtorie paguhet sipas kategorisë III-a/1 dhe nuk mund të paguhet sipas kategorisë III-b pasi kjo kategori është për sektorët në Rektorat që janë të veçuar dhe nuk janë pjesë përbërëse e një drejtorie.

Për atë kohë sa ka ndryshuar emërtesa nga përgjegjës sektori në përgjegjës sektori në nivel drejtorie madje ka dhe një urdhër të titullarit të institucionit për personelin ndihmës akademik me karakter administrativ për ndryshimin e kategorisë së pagës nga III-b në III-a/1 lind detyrimi ligjor të zbatohet kategoria e pagës për emërtesën përgjegjës sektori në Drejtori sipas kategorisë III-a/1.

Moskalimi i pagës sipas kategorisë përgjegjës sektori në drejtori përbën veprim në kundërshtim me ligjin.

Në lidhje me pretendimin se kalimi i përgjegjësave të sektorit në Drejtori nga kategoria III-b në kategorinë III-a/1, ka kosto financiare ju kujtojmë se zbatimi i VKM-së së pagave nuk kushtëzohet nga kostoja financiare. Kategorizimi i pozicioneve të punës sipas lidhjes 7 nuk është një e drejtë fakultative por përbën një detyrim ligjor për tu zbatuar nga institucionet sipas strukturës së re të miratuar me Vendim të Bordit të Administrimit.

Me datë 24.07.2018 Bordi i Administrimit del me vendim Nr. 59 mbi "Miratimin e nivelit të pagave të nënpunësve të administratës dhe punonjësve mbështetës të UAMD". Ky vendim nuk është në përputhje me nenin 67 pika 1 të ligjit nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në RSH", Udhëzimit Nr.27 datë 27.12.2017 të Ministres së Arsimit "Për strukturat e brendshme akademike dhe administrative në institucionet publike të arsimit të lartë". Udhëzimi i MASR përcakton qartasi që struktura brendshme akademike dhe administrative e institucionet përbëhet nga Personel Akademik, Personel ndihmës Akademik dhe personel administrativ, ndërkohë që tabela e përcaktimit të pagave në Vendimin Nr.59 i Bordit të Administrimit është e titulluar "Mbi kategorinë e pagës për çdo anëtar të personelit administrativ".

Sipas ligjit për arsimin e lartë si dhe këtij udhëzimi të MASR emërtesa "Përgjegjës Sektori në Drejtori" nuk është një strukturë administrative por është një strukturë ndihmës akademike me karakter administrativ në nivel institucioni dhe për pasojë punonjësit "Përgjegjës sektori" të përfshirë në këtë strukturë të cilët edhe kontratat e punës i kanë të lidhura me Rektorin e Institucionit duhet të trajtohen me pagë sipas kategorisë 3/a/1 në përputhje me urdhërin e Rektorit nr. 133 datë 27.06.2018.

Nisur sa më sipër:

Kërkohet ndryshimi në kategorinë e pagave të pozicioneve të punës së nënpunësve për emërtesën përgjegjës Sektori në Drejtori e cila të paguhet sipas lidhjes nr. 7 të VKM nr. 187, datë 08.03.2017 të ndryshuar, kategoria III-a/1.

Duke ju falenderuar,


DREJTOR
DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE DHE JURIDIKE
Blerina KOKA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 221/4 Prot.

Durrës më, 1/2 /2023

V E N D I M

Nr. 8 Datë 1/2 2023

PËR

"NDRYSHIME DHE SHTESA NË STRUKTURËN ANALITIKE TË PUNONJËSVE
BUXHETORË TË UNIVERSITETIT "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës "

Në mbështetje të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë", ligjit nr. 80/2015, datë 22.07.2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", VKM nr. 187, datë 08.03.2017 të ndryshuar, VKM nr. 621, datë 28.09.2022, Statutit të UAMD, Rregullores së UAMD, Vendimit të Bordit të Administrimit nr. 30, datë 31.05.2018 "Për miratimin e strukturës analitike të UAMD", të ndryshuar, vendimit të Senatit Akademik nr. 10, datë 26.01.2023 "Për ndryshime dhe shtesa në strukturën organike të UAMD", Bordi i Administrimit,

VENDOSI:

1. Miratimin e disa shtesa dhe ndryshimeve në strukturën analitike të punonjësve të Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës, sipas tabelës bashkëlidhur.
2. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi:
 - Administratori
 - Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Juridike
 - Drejtoria e Administrimit FinanciarKy vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR I BORDIT TË ADMINISTRIMIT

Ada ALIAJ



Efektii financiar vjetor per disa ndryshime ne strukture (ndryshim ne kategorine e pages)


Nr	Emertesa e pozicionit	Shkresa referuese	Nr i punonjeseve ne kete pozicion pune	Niveli aktual i pages sipas VKM nr. 621, date 28.9.2022, Lidhja nr.7 kategoria III-b	Niveli i propozuar i pages, kategoria III-a/1	Diferenca pozitive e shteses ne nje muaj	Efekti financiar vjetor per paga per nje punonjes	Efekti financiar vjetor (paga + sigurime) PER NJE PUNONJES	Efekti financiar vjetor (paga + sigurime) PER 18 PUNONJES	Shenime
1	Pergjegjes Sektori ne Drejtori	Shkresa per ndryshimit te kategorise se pages per emertesen "Pergjegjes sektori " sipas shkreses 1623 prot., date 02.11.2022	18	65,200	74,800	9,600	115,200	134,438	2,419,891	Nuk ka shtese ne numrin e personelit
2	ZV. Dekan nga kategoria "profesor "per ciklin e trete te studimeve ne FB	Shkresa nr. 63 date 11.01.2023 ardhur nga FB	1	17,000	1,275	18,275	219,300	255,923	255,923	Nuk ka shtese ne numrin e personelit
	TOTALI 1		19	82,200	76,075	27,875	334,500	390,362	2,675,814	-

Efekti financiar vjetor per disa shtesa ne numrin e personelit me kohe te plote

Nr	Emertesa e pozicionit	Shkresa referuese	Nr i punonjeve	Niveli aktual i pages/ shiteses ne page,	Shtesa per vjetersi dhe paga e grupit	Paga bruto ne nje muaj per nje punonjes	Effekti financiar vjetor per paga per nje punonjes	Effekti financiar vjetor sigurime per nje punonjes	Effekti financiar vjetor (paga + sigurime) per te gjithë punonjesit e shtuar	Shenime
1	Personel akademik nga kategoria "lektor" ne departamentin "Finance-kontabilitet ne FB	Shkresa nr. 63 date 11.01.2023 ardhur nga FB	1	103,850	7,789	111,639	1,339,668	223,725	1,563,393	Shërese ne nr e personelit

2	Personel akademik nga kategoria " asistent lektor" per FSHPJ	Shkresa nr. 84 prot., date 13.01.2023 ardhur nga FSHPJ	1	84,400	6,330	90,730	1,088,760	181,823	1,270,583	1,270,583	Shtese ne nr e personelit
3	Laborant prane FSP	Shkresa nr. 1798 prot., date 30.11.2022 ardhur nga FSP	2	40600	10000	50,600	607,200	101,402	708,602	1,417,204.80	Shtese ne nr e personelit
4	Specialist IT	Shkresa nr. 1852/1 prot., date 09.12.2022 ardhur nga Sektori i IT	1	52000	28500	80,500	966,000	161,322	1,127,322	1,127,322.00	Shtese ne nr e personelit
5	Specialist ne sektorin e projekteve (MSH)	Shkresa nr. 1852 prot., date 09.12.2022 ardhur nga Drejtoria e Projekteve	3	52000	21000	73,000	876,000	146,292	1,022,292	3,066,876.00	Shtese ne nr e personelit
6	Specialist ne Sektorin e Investimeve	Kerkese nga Sektori i Investimeve	1	52000	21000	73,000	876,000	146,292	1,022,292	1,022,292.00	Shtese ne nr e personelit
	TOTALI 2		9	384,850	94,619	479,469	5,753,628	960,856	6,714,484	9,467,670	-
TOTALI 1 + 2											12,143,485





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT
DREJTORIA E AUDITIMIT

Nr. 3236 Prot.

Tiranë, më 07.6 2023

Lënda: Dërgim "Raport verifikimi"

KONTROLLIT TË LARTË TË SHTETIT
Rruga "Abdi Toptani" Nr.1,

Tiranë

UNIVERSITETIT "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës
Lagja Nr.1, Rruga "Curilave",

Durrës

Në përgjigje të shkresës së KLSH nr.413/1, datë 17.05.2023 "Kërkesë për verifikim" bashkëlidhur ju dërgojmë "Raportin e verifikimit" të përgatitur nga Drejtoria e Auditimit.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM

Erzen Dola



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT
DREJTORIA E AUDITIMIT

MIRATOHET

DREJTOR

Skënder Jaku

RAPORT VERIFIKIMI

Mbi verifikimin e situatës në vijim të shkresës së dërguar nga KLSH me nr.413/1, datë 17.05.2023.

Në vijim të shkresës së KLSH nr.413/1, datë 17.05.2023, protokolluar në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, me nr.3236 prot., datë 18.05.2023, me objekt "Kërkesë për verifikim", me të cilën kërkohet që të verifikohet situata lidhur me parregullsitë e parashtruar në kërkesë/ankesën me nr.413 prot., datë 05.05.2023, nga znj.Anila Rapi, u bë verifikimi i situatës, dokumentuar me Akt verifikimi, ku rezultoi sa më poshtë vijon:

Në kërkesë/ankesën znj.Anila Rapi, me detyrë përgjegjëse e buxhetit në Drejtorinë e Administrimit Financiarë në UAMD shprehet se Bordi i Administrimit me vendimin nr.30, datë 31.05.2018 "Për miratim e strukturës së përgjithshme të Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës", ka miratuar strukturën e përgjithshme të Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës, në të cilin nuk ka përcaktuar nivelin e pagave. Gjithashtu shprehet se përgjegjësat e sektorëve vazhduan të paguheshin në kategorinë III-b, në kundërshtim me lidhjen nr.7, të VKM nr.187, datë 08.03.2017 "Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve, në kryeministri, aparatet e ministrave të linjës, administratën e presidentit, kuvendit, komisionit qendror të zgjedhjeve, gjykatën e lartë, prokurorinë e përgjithshme, disa institucione të pavarura, institucionet në varësi të kryeministrit, institucionet në varësi të ministrave të linjës dhe administratën e prefektit (1)(2)" i ndryshuar, ku pozicioni i përgjegjësit në drejtori parashikohet të paguhet me III-a/1.

Nga verifikimi dokumenteve rezultoi se:

Me vendimin nr.30, datë 31.05.2018, të Bordi i Administrimit, është miratuar dhe organizuar edhe Drejtoria e Administrimit Financiar me 2 sektor dhe 12 punonjës si më poshtë:

Drejtor	1
Sektori i Buxhetit	7
- Përgjegjës Sektori	1
- Specialist	5
- Magazinier	1
Sektori i pagesave të studentëve	4
- Përgjegjës Sektori	1
- Specialist	1

Rektori i universitetit me Urdhërin nr.133, datë 27.06.2018, ka kërkuar që kategoria e pagës për emërtesën 'Përgjegjës Sektori' në drejtori të ndryshojë nga III-b, në kategorinë III-a/1, referuar lidhjes 7, të VKM nr.187, datë 08.03.2017, i ndryshuar.

Administratori me shkresën nr.986/1, datë 28.06.2018, drejtuar Rektorit shprehet se Urdhëri i nxjerrë ka efekte të konsiderueshme financiare për institucionin dhe nuk mund të ekzekutohet pa kaluar për shqyrtim e vlerësim paraprak në Bordin e Administrimit, në cilësinë e organit më të lartë përgjegjës për marrjen e vendimeve me rëndësi për mbarrvajtjen e universitetit.

Bordi i Administrimit me vendimin nr.59, datë 24.07.2018, ka miratuar nivelet e pagave të nëpunësve të administratës dhe punonjësve mbështetës të UAMD, ku kategoria e pagës për emërtesën në pozicionin 'Përgjegjës Sektori' në të gjitha nivelet e organizimit është miratuar III-b. Nëpunësit e administratës dhe punonjësit mbështetës të UAMD, ishin paguar referuar nivelit të pagave të miratuar me këtë vendimin deri më datë 01.02.2023.

Me shkresën nr.1623/1, datë 02.11.2022, Rektori i universitetit i ka propozuar BA, trajtimin me pagë të emërtesës 'Përgjegjës Sektori' në drejtori, sipas kategorisë III-a/1, referuar VKM nr.187, datë 08.03.2017, i ndryshuar.



Bordi i Administrimit me vendimin nr.8, datë 01.02.2023 "Për ndryshime dhe shtesa në strukturën analitike të punonjësve buxhetor të Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës", ka miratuar ndër të tjera ndryshime në nivelet e pagave, ku emërtesa 'Përgjegjës Sektori' në drejtori, ka kaluar nga kategoria III-b, në kategorinë III-a/1, bazuar në VKM nr.187, datë 08.03.2017, i ndryshuar, pa patur ndryshime në lidhjen nr.7 të VKM.

Bazuar sa më sipër, rezulton se Bordi i Administrimit për trajtimin me pagë të emërtesës 'Përgjegjës Sektori' në drejtori, në 2 vendimet e marra ka mbajtur qëndrime të ndryshme, ndërkohë që situata është e njëjtë, pasi baza ligjore nuk ka ndryshime lidhur me këtë emërtesë.

Referuar VKM nr.187, datë 08.03.2017, i ndryshuar, administrata e universiteteve trajtohet në pikën 1/3/b dhe kategoritë e pagave të pozicioneve të punës së nëpunësve për emërtesat 'Specialist' deri në 'Titullar institucioni' janë përcaktuar sipas lidhjes nr.7, bashkëlidhur VKM, ku kategoria e pagës për emërtesën 'Përgjegjës Sektori', kur struktura është e organizuar në rang drejtorie rezulton III-a/1.

Konkluzioni i përgjithshëm është se në kushtet e mësipërme trajtimi me pagë i emërtesës 'Përgjegjës Sektori' në drejtori, në kategorinë III-b, është i gabuar dhe jo në përputhje me përcaktimet në lidhjen nr.7, bashkëlidhur VKM nr.187, datë 08.03.2017, i ndryshuar.

Rekomandim:

1. Bordi i Administrimit të urdhërojë Drejtorinë e Administrimit Financiar, që të bëjë përllogaritjet e pagës për emërtesën 'Përgjegjës Sektori' në drejtori, sipas kategorisë III-a/1, të përcaktuar në lidhjen nr.7, bashkëlidhur VKM nr.187, datë 08.03.2017, i ndryshuar, për periudhën nga data e lindjes të së drejtës, por jo më shumë se afati i parashkrimit për të drejtat e punëmarrësit kundrejt punëdhënësit dhe të punëdhënësit kundrejt punëmarrësit, të përcaktuara në pikën 1, të nenit 203, të Ligjit nr.7961, datë 12.7.1995 "Kodi i punës i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.
2. Në përfundim të përllogaritjes dhe pas kalkulimeve për efekt të rillogaritjes së tatimit mbi të ardhurat personale, si dhe të sigurimeve shoqërore e shëndetësore, të nxirren diferencat e papaguara dhe të bëhet pagesa për znj. Anila Rapi.

Për drejtorinë e auditimit:

Isa Neza



Ilirjana Çina





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 279/2 Prot.

Durrës, më 23/6 / 2023

Lënda: Objeksione mbi shkresën Nr.Prot 3236/1, datë 07.06.2023 me objekt "Dërgim raport verifikimi".

MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT
Drejtoria e Auditimit

KONTROLLIT TË LARTË TË SHTETIT

TI RANË

Të nderuar!

Në përgjigje të shkresës Tuaj, Nr. Prot., 3236/1 datë 07.06.2023 "Dërgim raport verifikimi", hartuar nga Drejtoria e Auditimit të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, ju dërgojmë objeksionet tona mbi raportin e verifikimit si më poshtë vijon:

Bordi i Administrimit të Universitetit "Aleksandër Moisiu", Durrës, i cili në kuptim të ligjit, është organi më i lartë kolegjal administrativ, i cili garanton përmbushjen e misionit të institucionit, mbarëvajtjen financiare dhe administrative të tij, ka ushtruar dhe ushtron funksionet sipas përcaktimeve të nenit 49 të Ligjit 80/2015, datë 22.07.2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë" dhe nenit 34 të Statutit të Universitetit "Aleksandër Moisiu", Durrës. Ky organ kolegjal në zbatim të:

1. Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, respektivisht nenit 57, pika 7 ku citohet "*Autonomia e institucioneve të arsimit të lartë dhe liria akademike janë të garantuara me ligj*".
2. Ligjit nr. 80/2015, datë 22.07.2015, respektivisht:
 - o Neni 3 "Liria akademike dhe autonomia e institucioneve të arsimit të lartë", pika 4. *gërma ç citon "Autonomia organizative dhe e përzgjedhjes së personelit garantohet nëpërmjet së drejtës për të caktuar në mënyrë të pavarur numrin e personelit, kriteret dhe procedurat e përzgjedhjes së tij, si dhe për të përcaktuar pagat e personelit, në përputhje me formën e institucionit"*;
 - o Neni 49, "Funksionet e Bordit të Administrimit në institucionet e arsimit të lartë", pika 1/a, pika 1/c, pikës 3 dhe 4.;
 - o Neni 108 "Autonomia financiare e institucioneve të arsimit të lartë", ku citohet: "Institucionet e arsimit të lartë funksionojnë sipas parimit të autonomisë financiare", "Institucioni i arsimit të lartë harton një plan buxhetor afatmesëm, i cili është pjesë e planit strategjik të zhvillimit të institucionit. Ky plan përditësohet çdo vit. Të gjitha të ardhurat e krijuara nga institucionet publike të arsimit të lartë përdoren prej tyre dhe pjesa e papërdorur e të ardhurave mbartet në vitin

pasardhës.

- c Nenit 67 "Personeli administrativ" ku citon: "*Kategoritë e personelit administrativ dhe nivelet e pagave miratohen nga Bordi i Administrimit të institucionit të arsimit të lartë, sipas legjislacionit në fuqi*".
- c Statutit të Universitetit "Aleksandër Moisiu", Durrës miratuar me vendim Senati nr. 33, datë 20.04.2018, respektivisht neni 5 "liria akademike, Autonomia financiare dhe organizative", pika 4 gërma d, ku citohet "Autonomia organizative dhe e përzgjedhjes së personelit garantohet nëpërmjet së drejtës për të caktuar në mënyrë të pavarur numrin e personelit, kriteret dhe procedurat e përzgjedhjes së tij, si dhe për të përcaktuar pagat e personelit akademik, ndihmës akademik dhe administrativ në përputhje me legjislacionin në fuqi" dhe nenit 34 pika 1/k,

Bazuar në sa më sipër, Bordi i Administritimit me vendim nr. 30, datë 31.05.2018 ka miratuar strukturën organizative të Universitetit "Aleksandër Moisiu", Durrës dhe me vendim nr. 59, datë 24.07.2018 ka miratuar nivelin e pagave për çdo anëtar të personelit administrativ.

Referuar lidhjes nr. 7 "Kategoritë e pagave të pozicioneve të punës së nëpunësve për emërtesat "Specialist" deri në "Titullar institucioni" në institucionet qendrore të përcaktuara sipas pikës 1/3/b, të këtij vendimi", për emërtesën "Përgjegjës Sektori" përcaktohen 3 nivele të page respektivisht III-a/1, III-b dhe IV-a.

Në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.187 date 08.03.2017, i ndryshuar, pika 2, gërma "ç" citon "Shtesa për pozicion është sipas kolonës 5, të Lidhjes nr. 1. Kategoritë e pagave për pozicionet e punës me emërtesë të njëjtë, të përcaktohen në kuadër të miratimit të strukturës dhe organikës së secilit institucion".

Bordi i Administrimit bazuar në parimin e autonomisë financiare dhe kompetencat e Bordit të Administrimit të përcaktuara në ligj, pasi analizoi kapacitetet e tyre financiare të Institucionit përcaktoi nivelet e pagave për çdo nëpunës të administratës në këtë Institucion. Nëpunësit të cilët ushtrojnë detyrën si "Përgjegjës Sektori", sipas vendimit nr 59, date 24.07.2018 janë trajtuar me pagë sipas kategorisë III-b të lidhjes nr. 7, të VKM – së nr. 187, datë 08.03.2017. Në të njëjtën kategori ishin trajtuar me pagë që nga dalja e këtij vendimi datë 08.03.2017.

Bordi i Administrimit, si Organi më i lartë kolegjal vendimmarrës për veprimtarinë financiare të Institucionit bazuar në shkresën nr. 1623/1, datë 02.11.2022 të Rektorit në të cilën i propozon Bordit të Administrimit ndryshimin e trajtimit me page për emërtesën "Pergjegjes sektori" nga III-b në III a/1 sipas lidhjes nr. 7 të VKM – së nr.187, datë 08.03.2017 dhe në respektim të nenit 34 "Funksionet e Bordit te Administrimit" të Statutit të Universitetit "Aleksandër Moisiu", ku pika k citon: "*Me propozim të Senatit Akademik dhe/ose të Rektorit Bordi i Administrimit merr vendim për nivelet e pagave të personelit administrativ dhe për trajtimin e veçantë financiar të personelit akademik*" si dhe në parimin e autonomisë financiare të Institucioneve të Arsimit të Lartë, pasi ka analizuar kapacitetet financiare të Institucionit, me Vendimin nr.8, datë 01.02.2023 ka vendosur brenda kornizave ligjore të VKM 187 datë 08.03.2017, ndryshimin e niveleve të pagës për emërtesën "Përgjegjës Sektori" nga III B në III-a/1.

Ju sjellim në vëmendje se edhe në Institucionet e tjera të Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë kategoria "Përgjegjës Sektori" është trajtuar dhe trajtohet me nivelin e pagës në kategorinë III-B.

Bordit të Administrimit, bazuar në ligjin e arsimit të lartë, statutin e Universitetit "Aleksandër Moisiu", Durrës, i lind e drejta të ndryshojëvendime në kuadër të autonomisë, por pa u dhënë këtyre vendimeve fuqi prapavepruese. Vendimet e ndryshuara lidhur me kategoritë/klasat për pozicione të caktuara në strukturën e universitetit nuk janë të zbatueshme për periudhën para hyrjes së tyre në fuqi, për aq kohë sa ato vetë nuk kanë një dispozitë të tillë të shprehur.

Bordi Administrimit të Universitetit Aleksandër Moisiu Durrës, në Vendimin nr. 8, datë 01.02.2023 "Për ndryshime dhe shtesa në strukturën analitike të punonjësve buxhetorë të Universitetit Aleksandër Moisiu Durrës", nuk ka rrëzuar apo vlerësuar si vendimarrje të padrejtë Vendimin nr. 59 datë 24.07.2018 të BA, por ka ndryshuar në kuadër të autonomisë financiare dhe institucionale nivelet e pageve të punonjësve. Kjo shprehet edhe në tekstin e vendimit nr. 8, pika 1: "Miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve...", ndaj gjykojmë që konkluzionet e grupit të auditit të ministrisë në lidhje me vendimarrjet e bordit, janë të gabuara.




Rekomandimet e lëna nga grupi i kontrollit të MAS sipas shkresës nr. 3236/1 datë 07.06.2023, ku citohet se Bordi i Administrimit duhet të urdhërojë Drejtorinë e Administrimit Financiar që të bëjë përlllogaritjet e pagave me emërtesën "Përgjegjës sektori në Drejtori" në kategorinë IIIa/1, dhe cakton si periudhë afatet parashikuara në nenin 203, pika 1 të Kodit të Punës, duke mos lexuar drejtë Vendimin nr. 8 datë 01.02.2023 të BA, i cili bazuar në ligjin e arsimit të lartë, i lind e drejta të ndryshojë vendime në kuadër të autonomisë, në çdo rast brenda kuadrit ligjor në fuqi, por pa u dhënë atyre fuqi prapavepruese. Nuk kuptohet arsyeja pse VKM 187, i ndryshuar, për grupin e kontrollit, lexohet si e mos zbatuar nga Vendimin nr. 59 datë 24.07.2018 i BA, kur e njëjta situatë dhe i njëjti interpretim gjendet i zbatuar edhe në IAL - të tjera, por përtej kësaj, vendimet e rishikuara të pagave nuk përkthehen si detyruese në kohë, nëse këto vendime nuk e shprehin këtë të fundit.

Bazuar në sa më sipër kërkojmë nga Ju, rishikimin e konkluzioneve, dhe pasjen në vendime të autonomisë insitucionale legjitimuar nga ligji nr. 80/2015, datë 22.07.2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Republikën e Shqipërisë."



KRYETAR I BORDIT TË ADMINISTRIMIT
ADA ALIAJ





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT
DREJTORIA E AUDITIMIT

Nr. 3236 Prot.

Tiranë, më 26.9.2023

Lënda: Përgjigje mbi objeksionet e paraqitura me shkresën nr.879/2 prot., datë 23.06.2023.

UNIVERSITETIT "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës
Lagja Nr.1, Rruga "Currilave",

Durrës

Në vijim të shkresës Tuaj nr.879/2, datë 23.06.2023 "Objeksione mbi shkresën nr.3236/1 prot., datë 07.06.2023 me objekt 'Dërgim raport verifikimi', protokolluar në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, me nr.3236/2 prot., datë 27.06.2023, Drejtoria e Auditimit i mori në shqyrtim objeksionet e paraqitura dhe pasi i analizoi arriti në përfundimet si vijon:

- a. Lidhur me sa shpreheni se Bordi i Administrimit me vendimin nr.30, datë 31.05.2018, ka miratuar strukturën organizative të Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës dhe me vendimin nr.59, datë 24.07.2018, ka miratuar nivelet e pagave për çdo anëtar të personelit administrativ, bazuar në legjislacionin e cilësuar në pikën 2, të observacinit tuaj, sqarjomë se:

Në nenin 49 "Funksionet e Bordit të Administrimit në institucionet e arsimit të lartë" të Ligjit nr.80, datë 22.07.2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", në asnjërën nga pikat që i referoheni nuk është përcaktuar se Bordi i Administrimit, miraton pagat, konkretisht ato citojnë:

- pika 1/a, "Garanton qëndrueshmërinë financiare të institucionit të arsimit të lartë dhe përmbushjen e misionit të tij";
- pika 1/c, "Me propozim të Senatit Akademik, miraton buxhetin vjetor dhe atë afatmesëm të institucionit dhe mbikëqyr zbatimin e tyre";
- pika 3, "Kompetencat për ushtrimin e funksioneve të parashikuara në shkronjat "b", "c", "ç", "d" dhe "dh", të pikës 1, të këtij neni, në institucionet jopublike të arsimit të lartë, përcaktohen në statutet e tyre";
- pika 4, "Funksione të tjera të Bordit të Administrimit përcaktohen në statutin e institucionit të arsimit të lartë".

Në nenin 34, të statutit ku janë përcaktuar funksionet e Bordit të Administrimit, në germën 'k', citohet: "Me propozim të Senatit akademik dhe/ose Rektorit, Bordi i Administrimit merr vendim për nivelet e pagave të personelit administrativ dhe për trajtimin e veçantë financiarë të personelit akademik".

Pikërisht bazuar në këtë të drejtë, Rektori i universitetit me Urdhërin nr.133, datë 27.06.2018 "Për ndryshimin e kategorisë së pagës për emërtesën 'Përgjegjës Sektori', ka kërkuar që kategoria e pagës për emërtesën 'Përgjegjës Sektori' në Drejtori, të ndryshojë nga III-b, në kategorinë III-a/1, referuar lidhjes 7, të VKM nr.187, datë 08.03.2017, i ndryshuar, të cilën BA në vendim nr.59, datë 24.07.2018 "*Miratimin e niveleve të pagave të nëpunësve të administratës dhe punonjësve mbështetës të Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës*", nuk e ka marrë në konsideratë, por ka përcaktuar kategorinë e pagës III-B, në kundërshtim me VKM nr.187, datë 08.03.2017, si dhe me strukturën dhe organikën e miratuar nga BA, me vendimin nr.30, datë 31.05.2018.

Në kushtet kur situata është e njëjtë, pasi baza ligjore nuk ka ndryshime lidhur me këtë emërtesë, në Nëntor të vitit 2022, Rektori me shkresën nr.1623/1, datë 02.11.2022, i ka propozuar përsëri BA, trajtimin me pagë të emërtesës 'Përgjegjës Sektori' në Drejtori, sipas kategorisë III-a/1, referuar VKM nr.187, datë 08.03.2017, i ndryshuar, bazuar në Urdhërin nr.133, datë 27.06.2018, të sipërcituar, si dhe bazuar në shkresën e Drejtorisë së Njerëzore dhe Juridike, Sektori i Sherbimëve Juridike nr.1623, datë 02.11.2022 "*Kërkohej trajtimi me pagë i emërtesës 'Përgjegjës Sektori' në drejtori, sipas kategorisë III-a/1, referuar VKM nr.187, datë 08.03.2017, i ndryshuar*", në të cilën shprehen:

- Urdhëri nr.133, datë 27.06.2018, është plotësisht i ligjshëm, pasi bazohet VKM nr.187, datë 08.03.2017, i ndryshuar, pika 1/3/b;
- Mos kalimi i pagës sipas kategorisë 'Përgjegjës Sektori' në Drejtori, përbën veprim në kundërshtim me ligjin;
- Pretendimi se kalimi i përgjegjësve të sektorit në Drejtori nga kategoria III-b në kategorinë III-a/1, ka kosto financiare ju kujtojmë se zbatimi i VKM së pagave nuk kushtëzohet nga kostoja financiare. *Kategorizimi i pozicioneve të punës sipas lidhjes 7*, nuk është një e drejtë fakultative, por përbën një detyrim ligjor për tu zbatuar nga institucionet, sipas strukturës së re të miratuar me vendimin e BA;
- Me datë 24.07.2018, Bordit të Administrimit del me vendimin nr.59, datë 24.07.2018 mbi "*Miratimin e niveleve të pagave të nëpunësve të administratës dhe punonjësve mbështetës të Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës*". Ky vendim nuk është në përputhje me nenin 67, pika 1, të Ligjit 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë". Udhëzimi nr.27, datë 27.12.2017, i Ministres së Arsimit "Për strukturat e brendshme akademike dhe administrative në institucionet publike të arsimit të lartë", përcakton qartazi që struktura e brendshme akademike dhe administrative e institucioneve përbëhet nga personel akademik, personel ndihmës akademik dhe personel administrativ, ndërkohë që tabela e përcaktimit të pagave në Vendimin nr.59, datë 24.07.2018, të BA është titulluar "Mbi kategorinë e pagës për çdo anëtar të personelit administrativ". Sipas ligjit për arsimin e lartë si dhe të këtij udhëzimi emërtesa 'Përgjegjës Sektori' në drejtori, nuk është një strukturë administrative, por është një strukturë ndihmës akademike, me karakter administrativ në nivel institucioni dhe për pasojë punonjësit 'Përgjegjës Sektori' në drejtori e përfshirë në këtë strukturë, të cilët edhe kontratat e punës i kanë të lidhura me Rektoratin e institucionit duhet të trajtohen me pagë sipas 3/a/1, në përputhje me Urdhërin e Rektorit nr.133, datë 27.06.2018.

Sa më sipër, 'Sektori i Shërbimeve Juridike' është shprehur se *"Kërkohej ndryshimi në kategorinë e pagave të pozicioneve të punës së nëpunësve për emërtesën 'Përgjegjës Sektori' në Drejtori, e cila të paguhet sipas lidhjes nr.7, të VKM nr.187, datë 08.03.2017, i ndryshuar, kategoria III-a/1"*.

Bordi i Administrimit me vendimin nr.8, datë 01.02.2023 "Për ndryshime dhe shtesa në strukturën analitike të punonjësve buxhetor të Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës", ka miratuar ndër të tjera ndryshime në nivelet e pagave, ku emërtesa 'Përgjegjës Sektori' në Drejtori, ka kaluar nga *kategoria III-b, në kategorinë III-a/1, bazuar në VKM nr.187, datë 08.03.2017, i ndryshuar, pa patur ndryshime në lidhjen nr.7 të VKM.*

Bazuar sa më sipër, rezulton se Bordi i Administrimit për trajtimin me pagë të emërtesës 'Përgjegjës Sektori' në Drejtori, në 2 vendimet e marra ka mbajtur 2 qëndrime të ndryshme, *ndërkohë që situata është e njëjtë dhe baza ligjore nuk ka ndryshime lidhur me këtë emërtesë.*

Theksojme faktin se referuar VKM nr.187, datë 08.03.2017, i ndryshuar, administrata e universiteteve trajtohet në pikën 1/3/b, si dhe kategoritë e pagave të pozicioneve të punës së nëpunësve për emërtesat 'Specialist' deri në 'Titullar institucioni' janë përcaktuar sipas lidhjes nr.7, bashkëlidhur VKM, ku kategoria e pagës për emërtesën 'Përgjegjës Sektori', kur struktura është e organizuar në rang Drejtorie rezulton III-a/1.

Në kushtet e mësipërme trajtimi me pagë i emërtesës 'Përgjegjës Sektori' në Drejtori, në kategorinë III-b, është jo korrekt dhe jo në përputhje me përcaktimet në lidhjen nr.7, bashkëlidhur VKM nr.187, datë 08.03.2017, i ndryshuar.

b. Lidhur me sa shpreheni se jeni bazuar në nenin 67 "Personeli administrativ", të Ligjit nr.80/2015 ku citon: *"Kategoritë e personelit administrativ dhe nivelet e pagave miratohen nga Bordi i Administrimit të Institucionit të Arsimit të Lartë, sipas legjislacionit në fuqi"*, Bordi i Administrimit në rastin konkret nuk i është përmbajtur përcaktimeve të legjislacionit në fuqi për pagat, konkretisht VKM nr.187, datë 08.03.2017, i ndryshuar, duke vepruar në kundërshtim me përcaktimet në lidhjen nr.7, të VKM-së dhe me strukturën e miratuar prej tij.

c. Lidhur me sa shpreheni se referuar lidhjes nr.7 "Kategoritë e pagave të pozicioneve të punës së nëpunësve për emërtesat 'Specialist' deri në 'Titullar institucioni' në institucionet qendrore të përcaktuar sipas pikës 1/3/b, të VKM nr.187, datë 08.03.2017, i ndryshuar, për emërtesën 'Përgjegjës Sektori', përcaktohen 3 nivele page respektivisht III-a/1, III-b dhe IV-a, interpretimi për rastin konkret nuk qëndron pasi struktura e miratuar nga BA, është e organizuar në rang Drejtorie me 2 sektor dhe për emërtesën 'Përgjegjës Sektori' kategoria korresponduese e pagës është taksative III-a-1, dhe nuk ka alternativa të tjera.

d. Lidhur me sa shpreheni se në VKM nr.187, datë 08.03.2017, i ndryshuar pika 2, gërma 'ç', citon: *"Shtesa për pozicion është sipas kolonës 5, të Lidhjes nr.1. Kategoritë e pagave për pozicionet e punës me emërtesë të njëjtë, të përcaktohen në kuadër të miratimit të strukturës dhe organikës së secilit institucion"*, interpretimi për rastin konkret nuk qëndron pasi Bordi i Administrimit, me vendimin nr.30, datë 31.05.2018, ka miratuar strukturën dhe organikën e përgjithshme të universitetit, sipas së cilës struktura ku ka punuar ankuesi, është e organizuar si Drejtorja e Administrimit Financiar me 2 sektor dhe 12 punonjës si më poshtë:

Drejtor	1
Sektori i Buxhetit	7
- Përgjegjës Sektori	1

- Specialist	5
- Magazinier	1
Sektori i pagesave të studentëve	4
- Përgjegjës Sektori	1
- Specialist	1

Ankusi ka qënë i punësuar në pozicionin e punës në emërtesën ‘Përgjegjës Sektori i Buxhetit’ në Drejtorinë e Administrimit Financiar, ku kategoria korresponduese e pagës është taksative III/a-1, sipas pikës 1/3/b, të VKM nr.187, datë 08.03.2017, i ndryshuar, lidhja nr.7. Bordi ka miratuar kategorinë e pagës për rastin konkret në kundërshtim edhe me strukturën dhe organikën e miratuar prej tij me vendimin nr.30, datë 31.05.2018, të sipërcituar.

e. Lidhur me sa shpreheni se Bordi i Administrimit bazuar në parimin e autonomisë financiare dhe kompetencat e Bordit të Administrimit të përcaktuara në ligj, pasi analizon kapacitetet e tyre financiare të institucionit përcaktoi nivelet e pagave për çdo nëpunës të administratës në këtë institucion. Nëpunësit të cilët ushtrojnë detyrën si ‘Përgjegjës Sektori’, sipas vendimit nr.59, datë 24.07.2018, janë trajtuar me pagë sipas kategorisë III-b të lidhjes nr.7, të VKM nr.187, datë 08.03.2017. Në të njëjtën kategori ishin trajtuar me pagë që nga dalja e këtij vendimi datë 08.03.2017, zbatimi i VKM nr.187, datë 08.03.2017 i ndryshuar, lidhur me përcaktimin e nivelit të pagave të administratës së universiteteve, ka qënë detyrim dhe nuk cënon autonominë financiare, si dhe nuk duhet të kushtëzohet nga efektet financiare të institucionit, për sa kohë nuk ka një klauzolë kushtëzimi në aktet/nënaktet ligjore përkatëse.

f. Lidhur me sa shpreheni se ju siellim në vëmendje se edhe në institucionet e tjera të arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë kategoria ‘Përgjegjës Sektori’, është trajtuar dhe trajtohet në kategorinë e pagës III-b, interpretimi është jo korrekt pasi kryerja e punës duhet të bëhet në referencë të akteve ligjore dhe jo referuar mënyrës se si e kryejnë institucionet e tjera, atë më tepër kur nuk është në përputhshmëri me aktet/nënaktet ligjore përkatëse në fuqi.

Konkluzion i përgjithshëm:

Bazuar në verifikimet e kryera dhe të trajtuara në raportin e verifikimit, si dhe në argumentet e sipërcituara në mënyrë të përmbledhur rezultojnë:

- Bordi i Administrimit nuk e ka marrë në konsideratë Urdhërin e Rektorit nr.133, datë 27.06.2018 “Për ndryshimin e kategorisë së pagës për emërtesën ‘Përgjegjës Sektori’;
- Bordi i Administrimit me vendimin nr.30, datë 31.05.2018, ka miratuar strukturën dhe organikën e përgjithshme të universitetit, por miratimin e niveleve të pagave nuk e ka bërë në kuadër të strukturës së miratuar dhe as sipas përcaktimeve në pikën 1/3/b, të VKM nr.187, datë 08.03.2017, i ndryshuar, lidhja 7, ku për emërtesën ‘Përgjegjës Sektori’ në Drejtori, kategoria e pagës është taksative III-a/1;
- Vendimi nr.59, datë 24.07.2018, Bordit të Administrimit mbi “Miratimin e niveleve të pagave të nëpunësve të administratës dhe punonjësve mbështetës të Universitetit “Aleksandër Moisiu” Durrës”, nuk është në përputhje me përcaktimet në nenin 67, pika 1, të Ligjit 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, ku citohet: “Kategoritë e personelit administrativ dhe nivelet e pagave miratohen nga Bordi i Administrimit të Institucionit të Arsimit të Lartë, sipas legjislacionit në

- fuqi*", pasi nuk ka marrë në konsideratë përcaktimet në VKM nr.187, datë 08.03.2017, i ndryshuar, si dhe strukturën/organikën e miratuar prej BA, me vendimin nr.30, datë 31.05.2018;
- Pretendimi se kalimi i përgjegjsave të sektorit në Drejtori nga kategoria III-b në kategorinë III-a/1, ka kosto financiare është jo korrekt, pasi zbatimi i VKM së pagave nuk kushtëzohet nga kostoja financiare, por përbën një detyrim ligjor për tu zbatuar nga institucionet, kostoja financiare duhej të ishte marrë parasysh në momentin e hartimit dhe miratimit të strukturës dhe organikës së universitetit;
 - Pretendimi i BA, se referuar lidhjes nr.7 "Kategoritë e pagave të pozicioneve të punës së nëpunësve për emërtesat 'Specialist' deri në 'Titullar institucioni' në institucionet qendrore të përcaktuar sipas pikës 1/3/b, të VKM nr.187, datë 08.03.2017, i ndryshuar, për emërtesën 'Përgjegjës Sektori', përcaktohen 3 nivele page respektivisht III-a/1, III-b dhe IV-a, është jo korrekt për rastin konkret, pasi struktura është e organizuar në rang Drejtorie me 2 sektor dhe për emërtesën 'Përgjegjës Sektori' kategoria korresponduese e pagës është taksative III-a-1, dhe nuk ka alternativa të tjera;
 - Bordi i Administrimit për trajtimin me pagë të emërtesës 'Përgjegjës Sektori' në Drejtori, në 2 vendimet e marra ka mbajtur 2 qëndrime të ndryshme, *ndërkohë që situata është e njëjtë dhe baza ligjore nuk ka ndryshime lidhur me këtë emërtesë.*
 - Zbatimi i VKM nr.187, datë 08.03.2017, i ndryshuar, lidhur me përcaktimin e nivelit të pagave të administratës së universiteteve, ka qënë detyrim dhe nuk cënon autonominë financiare, si dhe nuk duhej të ishte kushtëzuar nga efektet finaciare të institucionit, për sa kohë nuk ka një klauzolë kushtëzimi në aktet/nënaktet ligjore përkatëse;
 - Shprehja nga BA se ju sjellim në vëmendje se edhe në institucionet e tjera të arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë kategoria 'Përgjegjës Sektori', është trajtuar dhe trajtohet në kategorinë e pagës III-b, është jo korrekte, *pasi kryerja e punës duhet të bëhet në referencë të përcaktimeve në aktet/nënaktet ligjore dhe jo referuar mënyrës se si e kryejnë institucionet e tjera, aq më tepër kur trajtimi nuk është në përputhshmëri me aktet/nënaktet ligjore përkatëse në fuqi.*

Sa më sipër, në observacion si dhe në pretendimet e parashtruara nga Bordi i Administrimit, nuk është paraqitur asnjë dokument apo argument ligjor në mënyrë që grupi i auditit të ndryshojë qëndrim lidhur me raportin e verifikimit të mbajtur apo rishikimin e rekomandimeve, të cilat janë lënë në përputhshmëri të plotë me Ligjin nr.114/2015 "Për auditmin e brendshëm në sektorin publik", i ndryshuar, si dhe me Manualin e Auditmit të Brendshëm, i ndryshuar.

Zbatimi i rekomandimeve është kompetencë dhe përgjegjësi e Bordit të Administrimit, të Universitetit.

Grupi i punës

Isa Neza

Illirjana Çina



Drejtori

Skënder Jaku



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 1507/Prot.

Durrës, më 8/11/2023

Lënda: Kërkesë për vlerësimin e zbatimit të Rekomandimeve të Drejtorisë së Auditit të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit përcjellë me shkresë nr.3236/1 prot., datë 07.06.2023

KONTROLLIT TË LARTË TË SHTETIT

TIRANË

Të nderuar,

Refeuar shkresës Nr. Prot., 3236/6 datë 26.09.2023 "Kthim përgjigje mbi objeksionet e paraqitura në shkresën nr.879/2, datë 23.06.2023 të Bordit të Administrimit" nga Drejtoria e Auditimit të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit lidhur me ankesën e znj. Anila Rapi ju vëmë në dijeni mbi disa fakte si më poshtë vijon:

1. Znj. Anila Rapi ka qenë e punësuar në Universitetin "Aleksandër Moisiu" Durrës si Përgjegjëse e Sektorit të Buxhetit pranë Drejtorisë së Administrimit Financiar nga data 11.02.2015 deri në ndërprerjen e marrëdhënieve të punës datë 01.05.2023 për arsye të mbushjes së moshës së pensionit.
2. Trajtimi me pagë është bërë sipas vendimit nr. 59, datë 24.07.2018 të Bordit të Administrimit i cili ka miratuar nivelin e pagave për çdo anëtar të personelit administrativ.
3. Kërkesa e znj. Anila Rapi është iniciuar datë 05.05.2023 me objekt "Kërkesë Ankesë për moszbatim VKM 187 lidhja 7 Për pagat" drejtuar Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Bazuar në faktet e parashtruara si dhe referuar Rekomandimeve të Drejtorisë së Auditimit të Ministrisë së Arsimit ku pikën 1 citohet se "*Bordi i Administrimit të urdhërojnë Drejtorinë e Administrimit Financiar që të bëjë përllogaritjet e pagës për emërtesën "Përgjegjës Sektori" në drejtori sipas kategorisë III-a/1, të përcaktuar në lidhjen 7 bashkëlidhur VKM nr.187, datë 08.03.2017 i ndryshuar, për periudhën nga data e lindjes së të drejtës, por jo më shumë se afati i parashkrimit për të drejtat e punëmarrësit kundrejt punëdhënësit dhe të punëdhënësit kundrejt punëmarrësit, të përcaktuar në pikën 1 të nenit 203, të Ligjit nr.7961, datë 12.7.1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, lutemi për vlerësimin tuaj lidhur me zbatimin ose jo të Rekomandimeve të Drejtorisë së Auditit të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit.* Bashkëlidhur gjeni korrespondencën e plotë shkresore mbi këtë çështje.

KRYETAR I BORDIT TË ADMINISTRIMIT

Ada ALIAJ





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 2124 Prot.

Durrës, më 21/11/2023

Lënda: Kërkesë për sqarime të mëtejshme lidhur me Raportin e Verifikimit të Drejtorisë së Auditimit të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit përcjellë me shkresë nr.3236/1 prot., datë 07.06.2023

MINISTRISË SË ARSIMIT DHE SPORTIT
DREJTORISË SË AUDITIMIT

PËR DIJENI
SEKRETARIT TË PËRGJITHSHËM

TIRANË

Të nderuar!

Me shkresën nr.3236/1 prot., datë 7.6.2023, na është dërguar Raporti i Verifikimit, për gatitur nga Drejtoria e Auditimit, në përgjigje të shkresës së KLSH nr. 413/1, datë 17.5.2023 "Kërkesë për verifikim". Siç jeni në dijeni kjo procedurë verifikimi është iniciuar me kërkesë të znj. Anila Rapi, e cila në kohën e dërgimit të kërkesë/ankesës kishte ndërprerë marrëdhënien e punësimit me UAMD për arsye të mbushjes së moshës së pensionit.

Në përfundim, raporti i verifikimit përmban dy rekomandime.

Rekomandimi juaj, në pikën 1 parashikon si më poshtë:

"Bordi i Administrimit të urdhërojë Drejtorinë e Administrimit Financiar që të bëjë përlogaritjet e pagës për emërtesën "Përgjegjës Sektori" në drejtori sipas kategorisë III-a/1, të përcaktuar në lidhjen 7 bashkëlidhur VKM nr.187, datë 08.03.2017 i ndryshuar, për periudhën nga data e lindjes së të drejtës, por jo më shumë se afati i parashkrimit për të drejtat e punëmarrësit kundrejt punëdhënësit dhe të punëdhënësit kundrejt punëmarrësit, të përcaktuar në pikën 1 të nenit 203, të ligjit nr.7961, datë 12.7.1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.

Referuar pikës 1 të nenit 203 të ligjit nr.7961, datë 12.7.1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar: "Afati i parashkrimit për të drejtat e punëmarrësit kundrejt punëdhënësit, dhe të punëdhënësit kundrejt punëmarrësit është 3 vjet. Ky afat fillon nga data e lindjes të së drejtës".

Nisur nga situata konkrete, në kushtet kur na janë drejtuar me të njëjtën kërkesë edhe 8 (tetë) punonjës të tjerë të UAMD të cilët mbajnë detyrën e përgjegjësit të sektorit, dëshirojmë t'ju parashtojmë më

poshtë disa fakte dhe më tej të kërkojmë një sqarim të mëtejshëm lidhur me rekomandimet e paraqitura nga ju si njësi e specializuar.

1. Kërkuesja, znj. Anila Rapi është emëruar përgjegjëse e sektorit të buxhetit në Drejtorinë e Administrimit Financiar në UAMD në 11.02.2015.
2. Në datën e miratimit të Vendimit nr. 59, datë 24.07.2018 të Bordit të Administrimit të UAMD "Për miratimin e niveleve të pagave të nëpunësve të administratës dhe punonjësve mbështetës të UAMD", znj Rapi ka vijuar të ushtrojë detyrën e përgjegjëses së sektorit të buxhetit në Drejtorinë e Administrimit Financiar me kategorinë III/b të pagës.
3. Znj. Anila Rapi e ka ushtruar në mënyrë të pandërprerë këtë detyrë deri në datën 19.4.2023, datë në të cilën ka dalë në pension.

Nisur nga faktet e sipërpërmendura dhe nisur gjithashtu edhe nga kujtesa e përmendur nga ana juaj për respektimin e afatit të parashkrimit, na lejoni t'ju drejtojmë disa pyetje të cilat do të na qartësojnë më mirë për ta adresuar drejt problematikën e cila tashmë është shtrirë, siç u përmend më sipër, edhe në kërkesa të njëjta nga 8 (tetë) punonjës të UAMD që mbajnë detyrën e përgjegjësit të sektorit:

1. Kur fillon afati i parashkrimit në rastin e znj. Rapi, në datën 24.7.2018 kur është miratuar dhe ka hyrë në fuqi vendimi i Bordit të Administrimit "Për miratimin e niveleve të pagave të nëpunësve të administratës dhe punonjësve mbështetës të UAMD" apo në datën 05.05.2023, datë në të cilën znj. Rapi ka dërguar kërkesë/ankesën e saj?
2. Po nëse znj. Rapi ose një punonjës tjetër do të ishte emëruar në detyrën e përgjegjësit të sektorit në një datë të mëpasshme nga data e miratimit të Vendimit nr. 59, datë 24.07.2018 të Bordit të Administrimit, kur do të fillonte afati i parashkrimit, në datën e emërimit dhe trajtimit me pagë sipas vendimit të sipërpërmendur të Bordit, apo në datën e dërgimit të kërkesës?

Shpresojmë që një përgjigje e pyetjeve të mësipërme në një kohë sa më të shpejtë, do të na ndihmonte në adresimin përfundimtar të kërkesave që na janë drejtuar.

KRYETAR I BORDIT TË ADMINISTRIMIT

Ada ALIAJ

